



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, në bazë të nenit 32 të Rregullores së Këshillit Gjyqësor të Kosovës Nr. 01/2021 për Vlerësimin e Performancës së Gjyqtarëve, miraton këtë:

UDHËZUES PËR VLERËSIMIN E PERFORMANCËS SË GJYQTARËVE

I. Rregullat e përgjithshme

1. Qëllimi:

Qëllimi i këtij Udhëzuesi është definimi i mëtejshëm i formës së vlerësimit të performancës së gjyqtarëve mbi bazat e kritereve dhe treguesve të përcaktuar në nenin 27 të Ligjit Nr. 06/L-055 për KGJK-në, si dhe të Rregullores Nr. 01/2021 për Vlerësimin e Performancës së Gjyqtarëve.

2. Përkufizimet

A. Shprehjet e përdorura në këtë Udhëzues kanë kuptimet si në vijim:

Ligji – Ligji Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës;

Rregullore - Rregullorja Nr. 01/2021 e KGJK-së për Vlerësimin e Performancës së Gjyqtarëve;

Komisioni - Komisioni për Vlerësimin e Performancës së Gjyqtarëve;

Lëndë të vjetra - Me lëndë të vjetra nënkuptohen vetëm lëndët më të vjetra se dy vite siç është paraparë në Strategjinë Kombëtare për Reduktimin e lëndëve të vjetra.

KGJK – shkurtesë për Këshillin Gjyqësor të Kosovës.

Afati ligjor për nxjerrjen e vendimeve gjyqësore – afati i përcaktuar në ligjet procedurale të lëndëve të gjitha natyrave.

B. Shprehjet e përdorura në njëjës e kanë të njëjtin kuptim edhe në shumës. Fjalët e përdorura në një gjini përfshijnë gjininë tjetër.

3. Zbatueshmëria e Udhëzuesit

Ky Udhëzues zbatohet për vlerësimin e gjyqtarëve me mandat të përhershëm, dhe në rastet kur është e mundur, zbatohet edhe për gjyqtarët me mandat fillestar.

4. Mënyra e vlerësimit:

A. Shkallët e vlerësimit janë përcaktuar në nenin 14 të Rregullores:

Prej 0 deri në 34 pikë vlerësohet	“dobët”
Prej 35 deri në 50 pikë vlerësohet	“mjaftueshëm”
Prej 51 deri në 66 pikë vlerësohet	“mirë”
Prej 67 deri në 82 pikë vlerësohet	“shumë mirë”
Prej 83 deri në 89 pikë vlerësohet	“shkëlqyeshëm”

B. Kriteret dhe nën-kriteret e përcaktuara në këtë Udhëzues janë të bazuara në Rregullore, dhe vlejné për të gjithë gjyqtarët, përveç në ato raste kur kriteret apo nën-kriteret e caktuara nuk janë të aplikueshme për gjyqtarët e Gjykatës së Apelit dhe asaj Supreme.

C. Periudha e vlerësimit të gjyqtarit është numri i viteve kalendarike i përcaktuar me Rregullore. Nëse gjyqtari ka kryer detyrën e gjyqtarit për një periudhe më të shkurtër sesa periudha e përcaktuar e vlerësimit, do të vlerësohet ajo periudhë e detyrës së tij si gjyqtar.

5. Burimet e të dhënave

A. Burimet e informacionit që përdoren për vlerësimin e gjyqtarëve janë:

- a. Vendimet e zgjedhura sipas vendimit për përcaktimin e numrit për përzgjedhjen e rastësishme të vendimeve gjyqësore për vlerësimin e performancës së gjyqtarëve siç është paraparë në Rregullore;
- b. Dosja personale e gjyqtarit;
- c. Raporti i kryetarit të gjykatës, të konfirmuar nga udhëheqësi i departamentit/divizionit përkatës;
- d. Statistikat;
- e. Raporti i anëtarit raportues i Komisionit nga monitorimi i seancave dhe raporti i aktiviteteve trajnuese;
- f. Vendimet disiplinore; si dhe

- g. Çfarëdo dokumenti tjetër zyrtar që përmban informacione objektive dhe relevante lidhur me aktivitetet profesionale dhe sjelljen personale që ndikon në aktivitetet profesionale të gjyqtarit.

B. Burimet e informacionit të parapara në këtë nen zbatohen përshtatshëm për vlerësimin e gjyqtarëve me mandat fillestar, dhe shfrytëzimi i tyre kufizohet vetëm në indikatorë të matshëm dhe të zbatueshëm për gjyqtarët e Gjykatës Supreme.

C. Të dhënat për vlerësimin e performancës së gjyqtarit nuk mund të jenë më të vjetra se tre (3) vite nga viti në të cilin bëhet vlerësimi i performancës.

II. Rregullat për vlerësimin e informatave statistikore

6. Efikasiteti i zgjidhjes së lëndëve

A. Efikasiteti dhe koha e zgjidhjes së lëndëve vlerësohet duke analizuar:

- a. suksesin e gjyqtarit në realizmin dhe tejkalimin e normës për lëndët e zgjidhura (procesuara);
- b. krahasimi i numrit të lëndëve të zgjidhura nga ana e gjyqtarit me mesataren e lëndëve të zgjidhura nga gjykata përkatëse duke përfshirë natyrën e rastit;
- c. krahasimi i numrit të lëndëve të grumbulluara të gjyqtarit përkatës me mesataren e numrit të grumbulluar të gjykatës përkatëse; dhe
- d. kompleksitetit i lëndëve.

B. Faktorët tjerë që duhet të merren parasysh në rastet kur gjyqtari nuk arrin efikasitetin e nevojshëm të matshëm sipas paragrafit A, përfshijnë:

- a. numri i pamjaftueshëm i lëndëve;
- b. mungesa në punë për shkak të pushimit vjetor, pushimit mjekësor, festave dhe trajnimeve mbi pesë (5) ditë në muaj;
- c. angazhimi në grupe punuese, komisione nga KGJK apo nga autoritete tjera të përcaktuara me ligj.

7. Numri i lëndëve të vendosura në procedurë ankimore

A. Për qëllim të vlerësimit të performancës, lëndë të cilat janë vendosur sipas mjeteve juridike konsiderohen lëndët e vërtetuara dhe të ndryshuara, kurse lëndët e anuluar vlerësohen vetëm për shkak të shkeljeve esenciale.

B. Ky nen nuk është i zbatueshëm për gjyqtarët e Gjykatës Supreme.

8. Peshimi i lëndëve

A. Nëse ndryshe nuk rregullohet me ndonjë akt normativ të Këshillit në lidhje me peshimin e lëndëve, gjyqtari vlerësues, me mbështetjen e Sekretarit, duhet të përdorë këto definime të lëndëve komplekse:

- a. Si lëndë komplekse në Departamentin e Përgjithshëm - Divizioni Penal konsiderohen lëndët:
 - i. Lëndime të rënda trupore;
 - ii. Vjedhje e rëndë;
 - iii. Mashtrimi
 - iv. Si dhe të gjitha lëndët në të cilat, numri i të akuzuarve është mbi 5 (pesë) persona.
- b. Si lëndë komplekse në Departamentin për Krime të Rënda dhe përshtatshmërisht për Departamentin për të Mitur konsiderohen lëndët:
 - i. Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar;
 - ii. Kontrabandimi me migrant;
 - iii. Dhunim;
 - iv. Keqpërdorimi seksual i personave nën moshën 16 vjeçare;
 - v. Vrasje;
 - vi. Vrasje e rëndë;
 - vii. Trafikimi me njerëz;
 - viii. Krimi i organizuar;
 - ix. Terrorizmi;
 - x. Grabitja dhe vjedhja grabitqare;
 - xi. Si dhe të gjitha lëndët në të cilat, numri i të akuzuarve është mbi 5 (pesë) persona.
- c. Si lëndë komplekse në Departamentin Special konsiderohen të gjitha lëndët të cilat sipas ligjit janë në kompetencën e këtij departamenti.
- d. Si lëndë komplekse në Departamentin e Përgjithshëm - Divizioni Civil konsiderohen:
 - i. Kontestet pronësore (vërtetimi i pronësisë, dorëzimi i pronës, evitimi i shqetësimit dhe pjesëtimi i pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve);
 - ii. Kontestet nga e drejta reale (servitutet, barra sendore);
 - iii. Anulimi i kontratës (për të gjitha çështjet);
 - iv. Kontestet për fyerje dhe shpifje;
 - v. Kontestet në të cilat paraqitet kërkesa e ndërhyrësit kryesor dhe kontestet me kundërpadi.
- e. Si lëndë komplekse në Departamentin Administrativ konsiderohen:
 - i. Kontestet-Kadastër;
 - ii. Kontestet- Tatimet;

- iii. Kontestet- Dogana;
- iv. Kontestet-Prokurim.
- f. Si lëndë komplekse në Departamentin Ekonomik konsiderohen:
 - i. Falimentimi;
 - ii. Markat Tregtare.

B. Duke pasur parasysh peshën dhe rëndësinë e çështjeve të cilat nuk janë cekur më lartë, anëtarët e Komisionit kategorizojnë edhe lëndët e tjera, përveç lëndëve të përmendura më lartë.

9. Përpilimi i vendimeve gjyqësore

Komisioni do të marrë parasysh respektimin e afateve ligjore për hartimin e vendimeve gjyqësore.

III. Rregullat e vlerësimit

10. Rregullat e përgjithshme të vlerësimit

A. Vlerësimi i gjyqtarëve bëhet në dy faza. Faza e parë përfshinë vlerësimin e të gjitha kritereve dhe indikatorëve, përveç kriterit 3.1, 3.2, 3.3 dhe 4.4.1, të cilat vlerësohen në fazën e dytë.

B. Vlerësimi bëhet në përputhje me udhëzimet dhe rregullat e këtij Udhëzuesi dhe notimi për secilin gjyqtar bëhet përmes Formularëve A dhe B të këtij Udhëzuesi.

C. Gjyqtari vlerësues obligohet që për secilin tregues matës të vlerësuar të jap arsyetimin për vlerësim. Në rastet kur treguesit janë vlerësuar në bazë të të dhënave statistikore apo vendimeve gjyqësore, në arsyetim gjyqtari vlerësues i referon dhe liston ato të dhëna statistikore dhe vendime.

D. Faza e parë e vlerësimit është anonime, dhe identiteti i gjyqtarit të vlerësuar nuk bëhet i ditur për gjyqtarin vlerësues. Faza e dytë është fazë e hapur, ku identiteti i gjyqtarit të vlerësuar bëhet i ditur për gjyqtarin vlerësues. Në përfundim të vlerësimit të fazës së parë, gjyqtari vlerësues e nënshkruan Formularin A dhe e dorëzon te Kryetari ose Sekretari i Komisionit.

E. Vetëm pas dorëzimit të Formularit A të nënshkruar, gjyqtari vlerësues ka të drejtë të filloj vlerësimin e fazës së dytë. Pas përfundimit të vlerësimit, gjyqtari vlerësues e nënshkruan Formularin B dhe e dorëzon te Kryetari ose Sekretari i Komisionit.

IV. Rregullat e notimit të kritereve dhe treguesve matës

11. Kriteret për vlerësim

Kriteret e vlerësimit të performancës së gjyqtarëve sipas Ligjit dhe Rregullores, përcaktohen si në vijim:

1. Aftësia profesionale, bazuar në rezultatin e punës gjatë periudhës së vlerësimit, përfshirë pjesëmarrjen në formate të organizuara të trajnimit ku është vlerësuar performanca

Në këtë kategori një gjyqtar mund të vlerësohet nga zero (0) deri në dyzetë pikë pesë (40.5) pikë.

1.1. Menaxhimi efikas i lëndëve (0-5 pikë)

Udhëzimi: Vlerësimi i këtij indikator bëhet përmes të dhënave statistikore të nxjerra nga Zyra për Statistika në KGJK. Të zgjedhet vetëm një nga opsionet e ofruara.

1.1.1.	Nëse gjyqtari gjatë periudhës së vlerësimit ka zgjidhur mbi 25% të lëndëve më shumë se mesatarja e lëndëve të zgjidhura nga dep. përkatës i gjykatës përkatëse (referati përkatës)	(5 pikë)
1.1.2.	Nëse gjyqtari gjatë periudhës së vlerësimit ka zgjidhur mes 10-25% të lëndëve më shumë se mesatarja e lëndëve të zgjidhura nga dep. përkatës i gjykatës përkatëse (referati përkatës)	(4 pikë)
1.1.3.	Nëse gjyqtari gjatë periudhës së vlerësimit ka zgjidhur mes 0-10% të lëndëve më shumë se mesatarja e lëndëve të zgjidhura nga dep. përkatës i gjykatës përkatëse (referati përkatës)	(3 pikë)
1.1.4.	Nëse gjyqtari gjatë periudhës së vlerësimit ka zgjidhur 10-30% të lëndëve më pak se mesatarja e lëndëve të zgjidhura nga dep. përkatës i gjykatës përkatëse (referati përkatës)	(2 pikë)
1.1.5.	Nëse gjyqtari gjatë periudhës së vlerësimit ka zgjidhur 30-50% të lëndëve më pak se mesatarja e lëndëve të zgjidhura nga dep. përkatës i gjykatës përkatëse (referati përkatës)	(1 pikë)
1.1.6.	Nëse gjyqtari ka zgjidhur mbi 50% të lëndëve më pak se mesatarja e lëndëve të zgjidhura nga dep. përkatës i gjykatës përkatëse (referati përkatës)	(0 pikë)

1.2. Efikasiteti i zgjidhjes së lëndëve të vjetra në shqyrtim (0-5 pikë)

Udhëzimi: Vlerësimi i këtij indikator bëhet përmes të dhënave statistikore të nxjerra nga Zyra për Statistika në KGJK. Të zgjedhet vetëm një nga opsionet e ofruara.

1.2.1.	Nëse numri në shqyrtim i lëndëve të vjetra të gjyqtarit është mbi 25% më pak se numri i lëndëve të vjetra të departamentit përkatës në gjykatën përkatëse, (nëse ndarja e	(5 pikë)
--------	---	----------

	lëndëve tek gjyqtarët është bërë proporcionalisht sipas viteve të pranimit)	
1.2.2.	Nëse numri në shqyrtim i lëndëve të vjetra të gjyqtarit është mes 10-25% më pak se numri i lëndëve të vjetra të departamentit përkatës në gjykatën përkatëse, (nëse ndarja e lëndëve tek gjyqtarët është bërë proporcionalisht sipas viteve të pranimit)	(4 pikë)
1.2.3.	Nëse numri në shqyrtim i lëndëve të vjetra të gjyqtarit është në përpjesëtim të barabartë me numrin e lëndëve të departamentit përkatës në gjykatën përkatëse, (nëse ndarja e lëndëve tek gjyqtarët është bërë proporcionalisht sipas viteve të pranimit)	(3 pikë)
1.2.4.	Nëse numri në shqyrtim i lëndëve të vjetra të gjyqtarit është mes 10-30% më shumë se numri i lëndëve të vjetra të departamentit përkatës në gjykatën përkatëse, (nëse ndarja e lëndëve tek gjyqtarët është bërë proporcionalisht sipas viteve të pranimit)	(2 pikë)
1.2.5.	Nëse numri në shqyrtim i lëndëve të vjetra të gjyqtarit është mes 30-50% më shumë se numri i lëndëve të vjetra të departamentit përkatës në gjykatën përkatëse, (nëse ndarja e lëndëve tek gjyqtarët është bërë proporcionalisht sipas viteve të pranimit)	(1 pikë)
1.2.6.	Nëse numri në shqyrtim i lëndëve të vjetra të gjyqtarit është mbi 50% më shumë se numri i lëndëve të vjetra të departamentit përkatës në gjykatën përkatëse, (nëse ndarja e lëndëve tek gjyqtarët është bërë proporcionalisht sipas viteve të pranimit)	(0 pikë)

1.3. Shkalla e lëndëve të kryera në raport me lëndët e pranuar (0-5 pikë)

Udhëzim: Vlerësimi i këtij indikator bëhet përmes të dhënave statistikore të nxjerra nga Zyra për Statistika në KGJK. Të zgjedhet vetëm një nga opsionet e ofruara.

1.3.1.	Nëse gjyqtari gjatë periudhës vlerësuese ka arritur mbi 116% të shkallës së lëndëve të kryera në raport me lëndët e pranuar, nëse numri i lëndëve të pranuar nuk e kalon këtë përqindje - përqindja kalkulohet sipas numrit të përcaktuar si normë	(5 pikë)
1.3.2.	Nëse gjyqtari gjatë periudhës vlerësuese ka arritur nga 106-115% të shkallës së lëndëve të kryera në raport me lëndët e pranuar, nëse numri i lëndëve të pranuar nuk e kalon këtë përqindje - përqindja kalkulohet sipas numrit të përcaktuar si normë	(4 pikë)
1.3.3.	Nëse gjyqtari gjatë periudhës vlerësuese ka arritur nga 95-105% të shkallës së lëndëve të kryera në raport me lëndët e pranuar, nëse numri i lëndëve të pranuar nuk e kalon këtë	(3 pikë)

	përqindje - përqindja kalkulohet sipas numrit të përcaktuar si normë	
1.3.4.	Nëse gjyqtari gjatë periudhës vlerësuese ka arritur nga 85-94% të shkallës së lëndëve të kryera në raport me lëndët e pranuara, nëse numri i lëndëve të pranuara nuk e kalon këtë përqindje - përqindja kalkulohet sipas numrit të përcaktuar si normë	(2 pikë)
1.3.5.	Nëse gjyqtari gjatë periudhës vlerësuese ka arritur nga 75-84% të shkallës së lëndëve të kryera në raport me lëndët e pranuara, nëse numri i lëndëve të pranuara nuk e kalon këtë përqindje - përqindja kalkulohet sipas numrit të përcaktuar si normë	(1 pikë)
1.3.6.	Nëse gjyqtari gjatë periudhës vlerësuese ka arritur më pak 75% të shkallës së lëndëve të kryera në raport me lëndët e pranuara	(0 pikë)

1.4. Marrja, hartimi dhe dorëzimi i vendimeve brenda afateve kohore (0-5 pikë)

Udhëzim: Në lidhje me këto të dhëna, Zyra për Statistika në KGJK do të zgjedhë në mënyrë ‘random’ 30 vendime të gjyqtarit përkatës, për të cilat do të nxjerrë të dhënat e nevojshme në lidhje me afatet kohore dhe do t’ia ofrojë anëtarit përkatës të Komisionit. Të zgjedhet vetëm një nga opsionet e ofruara.

1.4.1.	Nëse gjyqtari gjatë periudhës vlerësuese ka respektuar afatet e përcaktuara ligjore për vendim me shkrim në përqindje mbi 91 - 100%	(5 pikë)
1.4.2.	Nëse gjyqtari gjatë periudhës vlerësuese ka respektuar afatet e përcaktuara ligjore për vendim me shkrim në përqindje mbi 80 - 90%	(4 pikë)
1.4.3.	Nëse gjyqtari gjatë periudhës vlerësuese ka respektuar afatet e përcaktuara ligjore për vendim me shkrim në përqindje mbi 56 - 79%	(3 pikë)
1.4.4.	Nëse gjyqtari gjatë periudhës vlerësuese ka respektuar afatet e përcaktuara ligjore për vendim me shkrim në përqindje nën 55%	(0 pikë)

1.5. Respektimi i normës orientuese (0-7 pikë)

Udhëzim: Vlerësimi i këtij indikator bëhet përmes të dhënave statistikore të nxjerra nga Zyra për Statistika në KGJK. Të zgjedhet vetëm një nga opsionet e ofruara.

1.5.1.	Nëse gjyqtari gjatë periudhës vlerësuese ka arritur të realizojë mbi 125% nga numri i përcaktuar si normë orientuese me Rregulloren e KGJK-së	(7 pikë)
1.5.2.	Nëse gjyqtari gjatë periudhës vlerësuese ka arritur të realizojë ne mes te 115 - 124% nga numri i përcaktuar si normë orientuese me Rregulloren e KGJK-së	(6 pikë)
1.5.3.	Nëse gjyqtari gjatë periudhës vlerësuese ka arritur të realizojë mes 105 - 114% nga numri i përcaktuar si normë orientuese me Rregulloren e KGJK-së	(5 pikë)
1.5.4.	Nëse gjyqtari gjatë periudhës vlerësuese ka arritur të realizojë mes 95 - 104% nga numri i përcaktuar si normë orientuese me Rregulloren e KGJK-së	(4 pikë)
1.5.5.	Nëse gjyqtari gjatë periudhës vlerësuese ka arritur të realizojë mes 80 - 94% nga numri i përcaktuar si normë orientuese me Rregulloren e KGJK-së	(3 pikë)
1.5.6.	Nëse gjyqtari gjatë periudhës vlerësuese ka arritur të realizojë mes 70-79% nga numri i përcaktuar si normë orientuese me Rregulloren e KGJK-së	(2 pikë)
1.5.7.	Nëse gjyqtari gjatë periudhës vlerësuese ka arritur të realizojë mes 60-69% nga numri i përcaktuar si normë orientuese me Rregulloren e KGJK-së	(1 pikë)
1.5.8	Nëse gjyqtari gjatë periudhës vlerësuese ka arritur të realizojë më pak se 60 % nga numri i përcaktuar si normë orientuese me Rregulloren e KGJK-së	(0 pikë)

1.6. Pjesëmarrja në trajnime gjyqësore (0-1.5 pikë)

Udhëzim: Të dhënat për gjyqtarin duhet të merren në bashkëpunim me Komisionin për Trajnime (Komisioni i përhershëm i KGJK-së). Vijueshmëria e rregullt definohet sipas Rregullores për Trajnime. Të zgjedhet vetëm një nga opsionet e ofruara.

1.6.1	Varësisht nga kategoria të cilës i takon gjyqtari i cili është i përfshirë në procesin e vlerësimit të performancës:	
	(a) Nëse, gjatë periudhës së vlerësimit, gjyqtarët përmbushin obligimin e tyre për vijueshmërinë në trajnimet për gjyqtarë me mandat të përhershëm në masën 100%	(1.5 pikë)
	(b) Nëse, gjatë periudhës së vlerësimit, gjyqtarët përmbushin obligimin e tyre për vijueshmërinë në trajnimet për gjyqtarë me mandat të përhershëm në masën 75-99%	(1 pikë)
	(c) Nëse, gjatë periudhës së vlerësimit, gjyqtarët përmbushin obligimin e tyre për vijueshmërinë në trajnimet për gjyqtarë me mandat të përhershëm në masën 50-74%	(0.5 pikë)

	(d) Nëse, gjatë periudhës së vlerësimit, gjyqtarët përmbushin obligimin e tyre për vijueshmërinë në trajnimet për gjyqtarë me mandat të përhershëm nën masën 50%	(0 pikë)
--	--	-----------------

1.7. Vullneti për të zgjidhur lëndë komplekse (0-4 pikë)

Udhëzim: Vlerësimi i këtij indikator bëhet përmes të dhënave statistikore të nxjerra nga Zyra për Statistika në KGJK. Të zgjedhet vetëm një nga opsionet e ofruara.

1.7.1	Nëse nga totali i lëndëve të zgjidhura, gjatë periudhës së vlerësimit gjyqtari ka zgjidhur mbi 15% lëndë komplekse	(4 pikë)
1.7.2	Nëse nga totali i lëndëve të zgjidhura, gjatë periudhës së vlerësimit gjyqtari ka zgjidhur mes 10-15% lëndë komplekse	(3 pikë)
1.7.3	Nëse nga totali i lëndëve të zgjidhura, gjatë periudhës së vlerësimit gjyqtari ka zgjidhur mes 6-9 % lëndë komplekse	(2 pikë)
1.7.4	Nëse nga totali i lëndëve të zgjidhura, gjatë periudhës së vlerësimit gjyqtari ka zgjidhur mes 2-5 % lëndë komplekse	(1 pikë)
1.7.5.	Nëse nga totali i lëndëve të zgjidhura, gjatë periudhës së vlerësimit gjyqtari ka zgjidhur më pak se 2% lëndë komplekse	(0 pikë)

1.8. Raporti ndërmjet vendimeve meritore dhe vendimeve procedurale (nga totali i vendimeve) (0-7 pikë)

Udhëzim: Vlerësimi i këtij indikator bëhet përmes të dhënave statistikore të nxjerra nga Zyra për Statistika në KGJK. Të zgjedhet vetëm një nga opsionet e ofruara.

1.8.1	Raporti ndërmjet vendimeve meritore dhe vendimeve procedurale (nga totali i vendimeve)	
	Nëse mbi 70% të vendimeve janë vendime meritore	(7 pikë)
	Nëse prej 65 - 69% të vendimeve janë vendime meritore	(6 pikë)
	Nëse prej 59-64% të vendimeve janë vendime meritore	(5 pikë)
	Nëse prej 53-58% të vendimeve janë vendime meritore	(4 pikë)
	Nëse prej 47-52% të vendimeve janë vendime meritore	(3 pikë)
	Nëse prej 41-46 % të vendimeve janë vendime meritore	(2 pikë)
	Nëse prej 36-40% të vendimeve janë vendime meritore	(1 pikë)
	Nëse nën 36 % të vendimeve janë vendime meritore	(0 pikë)
1.8.2	Përjashtimisht nga vlerësimi i mësipërm bëjnë rastet nëse gjyqtari gjatë periudhës së vlerësimit ka punuar kryesisht në procedurën e sigurimit të kërkesëpadsisë, procedurën përbarimore dhe në procedurën paraprake. Për përjashtimin e mësipërm vlerësimi bëhet sipas normës orientuese.	

1.9. Përdorimi i SMIL (nëse është në përdorim) (0-1 pikë)

Udhëzim: Vlerësimi i këtij indikator bëhet përmes të dhënave statistikore të nxjerra nga Zyra për Statistika në KGJK. Të zgjedhet vetëm një nga opsionet e ofruara.

1.9.1	Nëse gjyqtari e përdor programin SMIL në mënyrë të plotë	(1 pikë)
1.9.2	Nëse gjyqtari e përdor programin SMIL pjesërisht	(0.5 pikë)
1.9.3	Nëse gjyqtari nuk e përdor fare programin SMIL	(0 pikë)

2. Numrin e lëndëve të kthyera në rigjykim apo rivendosje, apo lëndëve të prishura nga gjykata më e lartë

Në këtë kategori një gjyqtar mund të vlerësohet nga zero (0) deri në katërbëdhjetë (14) pikë.

2.1. Numri i vendimeve të kthyera në procedurën sipas mjeteve të goditjes, për shkak të shkeljeve procedurale (0-7 pikë)

Udhëzim: Vlerësimi i këtij indikator bëhet përmes të dhënave statistikore të nxjerra nga Zyra për Statistika në KGJK. Të zgjedhet vetëm një nga opsionet e ofruara.

2.1.1.	Numri i vendimeve të kthyera në procedurë sipas mjeteve të goditjes, për shkak të shkeljeve procedurale:	
	(a) deri në 10% të vendimeve të prishura	(7 pikë)
	(b) prej 11-14% të vendimeve të prishura	(6 pikë)
	(c) prej 15-19% të vendimeve të prishura	(5 pikë)
	(d) prej 20-23 % të vendimeve të prishura	(4 pikë)
	(e) prej 24-27 % të vendimeve të prishura	(3 pikë)
	(f) prej 28-31 % të vendimeve të prishura	(2 pikë)
	(g) prej 32-35 % të vendimeve të prishura	(1 pikë)
	(h) mbi 35% të vendimeve të prishura	(0 pikë)

2.2. Numri i vendimeve të prishura në procedurë sipas mjeteve të goditjes, për shkak të vërtetimit të gabuar ose jo plotë të gjendjes faktike (0-7 pikë)

Udhëzim: Vlerësimi i këtij indikator bëhet përmes të dhënave statistikore të nxjerra nga Zyra për Statistika në KGJK. Të zgjedhet vetëm një nga opsionet e ofruara.

2.2.1.	Numri i vendimeve të prishura në procedurë sipas mjeteve të goditjes, për shkak të vërtetimit të gabuar ose jo të plotë të gjendjes faktike	
	(a) deri në 10% të vendimeve të prishura	(7 pikë)
	(b) prej 11-14% të vendimeve të prishura	(6 pikë)
	(c) prej 15-19% të vendimeve të prishura	(5 pikë)

	(d) prej 20 -23 % të vendimeve të prishura	(4 pikë)
	(e) prej 24-27 % të vendimeve të prishura	(3 pikë)
	(f) prej 28-31 % të vendimeve të prishura	(2 pikë)
	(g) prej 32-35 % të vendimeve të prishura	(1 pikë)
	(h) mbi 35% të vendimeve të prishura	(0 pikë)

3. Aftësia për të kryer detyrat në mënyrë të paanshme, të ndershme, me kujdes dhe me përgjegjësi, sjellja jashtë zyrës dhe integriteti personal

Në këtë kategori një gjyqtar mund të vlerësohet nga zero (0) deri në shtatë pikë pesë (7.5) pikë.

3.1. Dorëzimi apo vënia në dispozicion i të gjitha vendimeve tek personat përgjegjës për publikimin e vendimeve (0-1 pikë)

Udhëzim: Vlerësimi i këtij treguesi matës do të bëhet në bazë të vlerësimit të ofruara nga Kryetari i Gjykatës, të konfirmuar nga udhëheqësi i departamentit/divizionit përkatës. Të zgjedhet vetëm një nga opsionet e ofruara.

3.1.1.	Nëse gjyqtari ka dërguar 100% të vendimeve për publikim	(1 pikë)
3.1.2.	Nëse gjyqtari ka dërguar mbi 70% të vendimeve për publikim	(0.5 pikë)
3.1.3.	Nëse gjyqtari ka dërguar më pak se 70% të vendimeve për publikim	(0 pikë)

3.2. Bashkëpunimi i gjyqtarit me zyrtarët përgjegjës të administratës gjyqësore në lidhje me mirëmbajtjen e dosjes gjyqësore (0-2 pikë)

Udhëzim: Vlerësimi i këtij treguesi matës do të bëhet në bazë të vlerësimit të ofruara nga Kryetari i Gjykatës, të konfirmuar nga udhëheqësi i departamentit/divizionit përkatës. Vlerësimi bëhet për të dy nën treguesit matës.

3.2.1.	Nëse dosja gjyqësore e gjyqtarit është tërësisht e kompletuar	(0-1 pikë)
3.2.2.	Gjyqtari i dorëzon me rregull të gjitha dokumentacionet përcjellëse të lëndës tek zyrtarët përgjegjës	(0-1 pikë)

3.3. Sjellja profesionale e gjyqtarit, mos dhënia e informatave të rëndësishme dhe konfidenciale, përdorimi në mënyrë dinjitoze i rrjeteve sociale duke e ruajtur integritetin profesional dhe gjyqësor, shmangia e komunikimit ex-parte me palët në procedurë dhe qëndrimet apolitike (0-1.5 pikë)

Udhëzim: Gjatë vlerësimit të këtij treguesi matës njëri ndër burimet kryesor duhet të jetë vlerësimi i ofruar nga Kryetari i Gjykatës, të konfirmuar nga udhëheqësi i departamentit/divizionit përkatës. Vlerësimi bëhet për të gjithë nën treguesit matës.

3.3.1	Nëse gjyqtari ka sjellje profesionale dhe mbanë qëndrime apolitike	(0.5 pikë)
3.3.2	Nëse gjyqtari përdorë në mënyrë dinjitoze rrjetet sociale, duke e ruajtur integritetin profesional dhe gjyqësor	(0.5 pikë)
3.3.3	Nëse gjyqtari nuk zbulon informata të rëndësishme dhe konfidenciale	(0.5 pikë)

3.4. E kaluara disiplinore e gjyqtarit (0-3 pikë)

Udhëzim: Burim i të dhënave për këtë indikator janë vendimet disiplinore të shqiptuara gjatë periudhës vlerësuese. Të zgjedhet vetëm një nga opsionet e ofruara.

3.4.	Nëse ndaj gjyqtarit nuk ka ndonjë vendim disiplinor gjatë periudhës së vlerësimit	(3 pikë)
	Ndaj gjyqtarit është shqiptuar masa e vërejtjes jo publike me shkrim	(2 pikë)
	Ndaj gjyqtarit është shqiptuar masa e vërejtjes publike me shkrim	(1 pikë)
	Ndaj gjyqtarit është shqiptuar masa e zvogëlimit të përkohshëm të pagës, transferit të përkohshëm ose të përhershëm në një gjykatë tjetër të nivelit më të ulët	(0 pikë)

4. Njohuria profesionale, përvoja e punës dhe performanca, përfshirë njohuritë, respektimin e të drejtave të njeriut dhe aftësia komunikuese

Në këtë kategori një gjyqtar mund të vlerësohet nga zero (0) deri në tetë (8) pikë.

4.1. Njohuria e ligjeve të aplikueshme(0-1.5 pikë)

Udhëzim: Si burim i informacionit për vlerësimin e këtij treguesi matës janë gjashtë (6) vendimet meritore të gjyqtarit. Të zgjedhet vetëm një nga opsionet e ofruara.

4.1.1.	Aftësia e referimit të duhur në ligje (materiale dhe procedurale), si dhe njohuria e tij për legjislacionin e aplikueshëm:	
	(a) të gjitha vendimet kanë referencë në ligjet e aplikueshme	(1.5 pikë)
	(b) më tepër se gjysma e vendimeve kanë referencë në ligjet e aplikueshme	(1 pikë)
	(c) më pak se gjysma e vendimeve kanë referencë në ligjet e aplikueshme	(0.5 pikë)
	(d) asnjë nga vendimet nuk kanë referencë në ligjet e aplikueshme	(0 pikë)

4.2. Përvoja e punës gjyqësore (0.5-1.5 pikë)

Udhëzim: Gjatë vlerësimit të këtij treguesi matës merren parasysh të dhënat që sigurohen nga departamentet përkatëse në KGJK. Të zgjedhet vetëm një nga opsionet e ofruara.

4.2.1.	Më shumë se pesëmbëdhjetë (15) vite përvojë pune	(1.5 pikë)
4.2.2.	Mbi tetë (8) deri në pesëmbëdhjetë (15) vite përvojë pune	(1 pikë)
4.2.3.	Prej tri (3) deri në tetë (8) vite përvojë pune	(0.5 pikë)

4.3. Zbatim i standardeve juridike ndërkombëtare (0-1 pikë)

Udhëzim: Gjatë vlerësimit të këtij treguesi matës merren parasysh gjashtë (6) vendimet meritore të gjyqtarit. Ky tregues matës vlerëson zbatimin e standardeve ndërkombëtare lidhur me të drejtat e njeriut gjatë procedurës gjyqësore si dhe në kuadër të vendimeve gjyqësore. Të zgjedhet vetëm një nga opsionet e ofruara.

4.3.1.	Gjyqtari gjatë periudhës së vlerësimit i ka zbatuar standardet juridike ndërkombëtare	(0-1 pikë)
--------	---	-------------------

4.4. Komunikim i qartë dhe logjik (0-4 pikë)

Udhëzim: Për vlerësimin e këtij treguesi matës, gjyqtari vlerësues përcjellë një seancë gjyqësore të gjyqtarit në vlerësim. Vlerësimi bëhet për të dy nën treguesit matës.

4.4.1.	Nëse gjyqtari shfaqë aftësi të artikulimit të qartë dhe logjik:	
	Nëse gjyqtari shfaqë aftësi të mira të artikulimit të qartë dhe logjik gjatë seancës	(2 pikë)
	Nëse gjyqtari shfaqë aftësi mesatarisht të mira të artikulimit të qartë dhe logjik gjatë seancës	(1 pikë)
	Nëse gjyqtari nuk shfaqë aftësi të artikulimit të qartë dhe logjik gjatë seancës	(0 pikë)
4.4.2.	Trajtimi i barabartë dhe me respekt dhe dinjitet i të gjitha palëve në procedurë:	
	Nëse gjyqtari paraqet në mënyrë të plotë trajtim të barabartë dhe me respekt dhe dinjitet i të gjitha palëve në procedurë gjatë seancës	(2 pikë)
	Nëse gjyqtari paraqet mesatarisht trajtim të barabartë dhe me respekt dhe dinjitet i të gjitha palëve në procedurë gjatë seancës	(1 pikë)
	Nëse gjyqtari nuk paraqet trajtim të barabartë dhe me respekt dhe dinjitet i të gjitha palëve në procedurë gjatë seancës	(0 pikë)

5. Kapaciteti për arsyetime ligjore dhe aftësia në analizimin e problemeve ligjore

Në këtë kategori një gjyqtar mund të vlerësohet nga zero (0) deri në nëntëmbëdhjetë (19) pikë.

5.1. Cilësia dhe arsyetimi i vendimit (0-14 pikë)

Udhëzim: Gjatë vlerësimit të këtij treguesi matës merren parasysh gjashtë (6) vendimet meritore të gjyqtarit. Shih shënimet në secilin tregues matës për formën e vlerësimit.

5.1.1	Struktura e vendimit: nëse vendimi i përmban të gjitha elementet e përcaktuara me ligj: hyrja e vendimit, dispozitivi, arsyetimi dhe këshilla juridike (<i>zgjedh vetëm një nga opsionet e mëposhtme</i>)	
	(a) Në të gjitha vendimet	(3 pikë)
	(b) Në gjysmën, apo më shumë se gjysmën, e vendimeve	(2 pikë)
	(c) Në më pak se gjysmën e vendimeve	(1 pikë)
	(d) Në asnjë vendim	(0 pikë)
5.1.2.	Nëse arsyetimi i vendimit i sqaron pikat në vijim: (<i>vlerëso secilin nën tregues matës</i>)	
	A. Baza juridike është e qartë:	Zgjedh njëjërën
	(a) Në të gjitha vendimet	(2 pikë)
	(b) Në 51-84% të vendimeve	(1.5 pikë)
	(c) Në 35-50% të vendimeve	(1 pikë)
	(d) Në 16-34% të vendimeve	(0,5 pikë)
	(e) Në asnjë vendim	(0 pikë)
	B. Vlerësimi i provave është i qartë:	Zgjedh njëjërën
	(a) Në të gjitha vendimet	(3 pikë)
	(b) Në 51-84% të vendimeve	(2 pikë)
	(c) Në 35-50% të vendimeve	(1 pikë)
	(d) Në 16-34% të vendimeve	(0.5 pikë)
	(e) Në asnjë vendim	(0 pikë)
	C. Elaborimi i fakteve kontestuese është i qartë:	Zgjedh njëjërën
	(a) Në të gjitha vendimet	(3 pikë)
	(b) Në 51-84% të vendimeve	(2 pikë)
	(c) Në 35-50% të vendimeve	(1 pikë)
	(d) Në 16-34% të vendimeve	(0.5 pikë)
	(e) Në asnjë vendim	(0 pikë)
	D. Përfundimi i nxjerrë është në harmoni me praktiken unike të promovuar përmes qëndrimeve parimore, mendimeve juridike, udhëzuesve dhe vendimeve gjyqësore	Zgjedh njëjërën
	(a) Në të gjitha vendimet	(3 pikë)
	(b) Në 51-84% të vendimeve	(2 pikë)
	(c) Në 35-50% të vendimeve	(1 pikë)

	(d) Në 16-34% të vendimeve	(0.5 pikë)
	(e) Në asnjë vendim	(0 pikë)

5.2. Aftësia analitike e gjyqtarit (0-5 pikë)

